

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Rustem Thaqi - kryetar i kolegjit, Albert Zogaj dhe Fejzullah Rexhepi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses: Korporata Energjetike e Kosovës - KEK Divizioni Rrjetit - Distrikti Gjilan, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi D.R., sipas autorizimit, kundër të paditurit: S.M., nga fshati ... Komuna e Kamenicës, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, C.nr.111/2012, i datës 16.04.2014, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 30.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar të ankesa e të paditurit: S.M., nga fshati ... Komuna e Kamenicës, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, C.nr.111/2012, i datës 16.04.2014, dhe çështja lëndore gjykohet si ne vijim: REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses: Korporata Energjetike e Kosovës - KEK Divizioni Rrjetit - Distrikti Gjilan, me çka kërkuar që të OBLIGOHET i padituri S.M. nga fshati ..., që në emër të dëmit të shkaktuar paditëses, për shkak të shfrytëzimit të pa autorizuar të energjisë elektrike, t'i paguajë shumën prej 270,88 € (dyqindën e shtatëdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent) me kamatë prej 3.5% nga dita e ushtrimit padisë përkatësisht datës 02.08.2012, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 dite, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcenim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.111/2012, i datës 16.04.2014, Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses KEK-ut, Divizioni i Rrjetit - Distrikti Gjilan tani KEDS-i dhe detyrohet i padituri S.M. nga fshati ..., që në emër të dëmit të shkaktuar paditëses, për shkak të shfrytëzimit të pa autorizuar të energjisë elektrike, t'i paguajë shumën prej 270,88 € (dyqindën e shtatëdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent) me kamatë prej 3.5% nga dita e ushtrimit padisë përkatësisht datës 02.08.2012, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi, secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi i padituri, në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimi e goditur për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të anulohet aktgjykimin e atakuar dhe çështja të kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim dhe vendosje.

Ankesa i është dorëzuar paditëses. Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton së paditësi KEK-u Divizioni i Rrjetit - Distrikti Gjilan, me datën 02.08.2012, ka paraqitur padi, kundër të paditurit Selmon Nezir Maliqi, nga fshati ... Komuna e Kamenicës, për shkak të kompensimit të dëmit, me të cilën ka kërkuar që të Miratohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit të KEK-ut, Distrikti në Gjilan, në tërësi si e bazuar, Obligohet i padituri që paditësit t'ia paguaj dëmin e shkaktuar material në shumë prej 270,88 €, dhe atë me kamat ligjore, duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë e gjerë në pagesën definitive si dhe shpenzimet e këtij kontesti të gjitha në afat prej 15 ditësh, me kërcënim përmbarimi.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se pas administrimit të provave: aktgjykimin P.nr.63/11 prej datës 23.08.2011, kartelën e transaksionit të konsumatorit nr. 86865 prej datës 15.04.2014, faturat për përlllogaritjen e dëmit humbjeve nr.1567 prej datës 09.12.2010, faturat nr. DGL 10HP 02422 prej datës 09.12.2011 në emër të paditurit, pas vlerësimit të tyre e Aprovejje si të bazuar kërkesëpadia e paditëses KEK-ut, Divizioni i Rrjetit - Distrikti Gjilan tani KEDS-i dhe detyrojë të padituri S.M. nga fshati ..., që në emër të dëmit të shkaktuar paditëses, për shkak të shfrytëzimit të pa autorizuar të energjisë elektrike t'ia paguajë shumën prej 270,88 €, me kamat prej 3.5% nga dita e ushtrimit padisë përkatësisht datës 02.08.2012, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkalles së parë rreth mënyrës së vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore sipas pretendimeve ankimore të palës ankuese, sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore ku për pasojë më rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar ka pasur zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë konstaton një gjendje tjetër faktike nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditëses del të jetë e bazuar, me çka në rastin konkret ka kushte që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, ku edhe u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Sipas Gjykatës së Apelit, me shikimin dhe vlerësimin e shkresave të lëndës, rezulton se i padituri gjerë me datën 08.11.2010, me qëllim që vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm ka shfrytëzuar energjinë elektrike, jashtë njësorit elektrik me numër

30201296, duke i shkaktuar dëme paditëses në lartësi 270,88 €, lartësia e dëmit është vërtetuar në bazë të faturës me numër 1567 e datës 09.12.2010, fatura me numër DGL 10HP02422 e datës 09.12.2010, dhe dokumenti - transaksionet e konsumatorit i datës 24.07.2012 dhe dokumenti - transaksionet e konsumatorit i datës 15.04.2014. Ndërsa nga dokumenti transaksionet e konsumatorit i datës 05.05.2014, të cilin i padituri ja ka bashkangjitur ankesës të ushtruar kundër aktgjyqimit të atakuar, rezulton se këtu i padituri ka paguar dëmin paditëses dhe atë në dy rata me datën 23.08.2013 në shumën prej 162,93 € dhe me datën 16.09.2013 në shumën prej 116,00 € dhe me çka rezulton se i padituri e ka përmbushur detyrimin e tij, në emër kompensimit të dëmit për çka është detyruar ta përmbush me aktgjykimin e atakuar.

Mbi bazën e një gjendje të tillë faktike sipas Gjykatës se Apelit erdhi në përfundim se i padituri e ka përmbushur në tërësi dëmin e shkaktuar për të cilin është detyruar ta përmbush me aktgjykimin e atakuar. Për të ardhur në një përfundim të tillë gjykata mori për bazë edhe faktin se paditëses ju ka dorëzuar ankesa me datë 15.05.2014, mirëpo e njëjta nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë dhe pretendimet e të paditurit nuk i ka kontestuar.

Me dispozitën e nenit 154 të LMD-së përcaktohet se: “ kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ja kompensoj, në çoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij “, neni 158 përcakton se: “ fajësia eksitojnë kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia “, mirëpo i padituri e ka përmbushur detyrimin e tij, fakt që vërtetohet në bazë të dokumentit transaksionet e konsumatorit i datës 05.05.2014.

Prandaj, nga të lartcekurat e në mbështetje të nenit 195 .1 pika e), e lidhur me nenin 201 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr. 2907/14, me datë 30.10.2017

Kryetari i kolegjit
Rrustem Thaqi, d.v.